

Çështje të trajtimit dhe të klasifikimit të togfjalëshave emërorë

Mr. Agim Spahiu

26 maj 2002

Përmbledhje

Në këtë shkrim flitet për funksionin më themelor të togfjalëshave në gjuhën shqipe si dhe për klasifikimin e tyre që është bërë nga ana e studiuesve shqiptarë. Në këtë shkrim kemi përfshirë edhe disa mënyra të klasifikimit të këtyre lloje togfjalëshave në gjuhë dhe gjuhësi të tjera, klasifikim ky të cilin duhet ta ndjekim edhe ne në gjuhësinë tonë.

1 Njohuri të përgjithshme mbi togfjalëshin

Në këtë kumtesë për objekt shqyrtimi kemi marrë çështjen e trajtimit dhe klasifikimit të togfjalëshave emërorë, në përgjithësi, në gjuhësinë shqiptare dhe në atë të përgjithshme. Mirëpo, meqë ky lloj togfjalëshi është pjesë përbërëse e të gjithë togfjalëshave të tjerë të cilët u nënshtrohen kritereve të përbashkëta a të përgjithshme, atëherë ne këtu e pamë të udhës që në përgjithësi t'i vështrojmë shkurtimisht edhe tipet e tjera të togfjalëshave në këto dy gjuhësi, sepse, për mendimin tonë, vetëm kështu na del pasqyrimi më i qartë dhe më i plotë për këtë gjymtyrë sintaksore.

Togfjalëshi është një njësi sintaksore që është trajtuar mjaft gjerësisht si në gjuhësinë shqiptare, ashtu edhe në gjuhësinë e përgjithshme. Por mënyra e trajtimit të kësaj njësie gjuhësore dallon dukshëm në këto dy gjuhësi si në çështjen e përkufizimit, ashtu edhe në atë të klasifikimit të saj e në çështje të tjera që do t'i shohim më poshtë, për vetë faktin se janë zbatuar rrugë të ndryshme hulumtuuese, duke u mbështetur në kritere të ndryshme.

Në këtë shkrim do të përpiqemi t'i vëmë në dukje disa nga këto pika, me qëllim që të krijohet kështu një pasqyrë më e qartë e rrugëve teorike që janë ndjekur në këto dy gjuhësi, por duke mos harruar edhe pikëpërkimet ose rrugët konverguese që duhet t'i ndjekë, sidomos gjuhësia jonë kah ajo e përgjithshmja a botërorja, sepse, në këtë mënyrë, edhe rezultatet nuk do t'i mungonin në të ardhmen. Ky është edhe synimi i këtij shkrimi.

2 Në gjuhësinë shqiptare

Termin togfjalësh e ka sajuar gjuhëtari i njohur S. **Floqi** qysh në vitin 1968 (nga fjala tog, në emërore dhe fjalësh, në kallëzore). Ai është edhe i pari që iu qas në mënyrë shkencore-teorike kësaj njësie sintaksore. Lidhur me të ai e ka botuar në revistën "Studime filologjike", nr. 1/1968, f. 75-84, studimin me titull "Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme". Ky studim është marrë pastaj për bazë edhe për kapitullin e veçantë të gramatikës universitare dhe për ato shkollore (për të gjitha nivelet), me disa ndryshime minimale.

Në këtë studim **Floqi** këtë çështje e ka vështruar nga shumë anë e aspekte: Së pari, e merr në shqyrtim çështjen e emërtimit, duke bërë krahasime me disa gjuhë të tjera, pastaj ndalet te çështja e përkufizimit, në çështjen se çka mund të hyjë e çka jo në këtë njësi dhe në fund merret me klasifikimin, që është pjesa më kryesore dhe më voluminoze e studimit, ngase shtjellohet veç e veç secili lloj i tyre me shembuj të shumtë. Sipas S. **Floqit**, togfjalëshi është njësi sintaksore strukturore e përfutur nga bashkimi gramatikor dhe kuptimor i dy ose më shumë fjalëve kuptimplota të bashkuara me lidhjen e nënrenditjes, që tregon marrëdhënie midis sendeve, fenomeneve, proceseve e tipareve.

Nga ky përkufizim del se togfjalësha mund të sajojnë vetëm emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet dhe ndajfoljet të cilat, në përgjithësi, konsiderohen fjalë kuptimplota (në bazë të veçorive leksikore, kriterit semantik, -nënviz. imi A. S.); Lidhja e fjalëve që sajojnë togfjalësha, siç shihet edhe nga përkufizimi, është nënrenditja; Në togfjalësha mund të shprehen marrëdhëniet: objektore (marrëdhëniet midis veprimit dhe objektit, p. sh. : nis trenin, dëgjoj muzikë etj.); përcaktore a atributive (p. sh. : njëqind libra, shirat e vjeshtës, bukë gruri, shkop i thantë etj.); rrethore (vendore, kohore, shkakore etj.) dhe predikative a kallëzuesore (marrëdhëniet midis bartësit të veprimit a të gjendjes dhe të veprimit, si p. sh. : Ai iku, Hapësira jehonte, Shiu pushoi). Pastaj, duke u mbështetur në gjymtyrën kryesore, sipas pjesëve të ligjëratës, aty flitet për 6 grupe togfjalëshash, si:

1. Togfjalëshat emërorë,
2. Mbiemërorë,
3. Numërorë,
4. Përemërorë,
5. Foljorë dhe
6. Ndajfoljorë;

Në këta togfjalësha, sipas **Floqit**, veprojnë 4 lidhje:

- a) Lidhja e përshtatjes,
- b) E drejtimit,
- c) E bashkimit dhe

ç) Predikative;

Duke u mbështetur në numrin e gjymtyrëve në togfjalësha, ata janë ndarë në: togfjalësha të thjeshtë dhe të zgjeruar. Të thjeshtë konsiderohen të gjithë ata togfjalësha që kanë të paktën dy fjalë kuptimplota, ndërsa të zgjeruarit më shumë se dy fjalë të këtilla.

Jashtë teorisë së togfjalëshit janë lënë vargjet e fjalëve të bashkuara me bashkërenditje, si p. sh. : grurë e misër, grurë, misër e tërshërë;mëngjes, drekë e darkë etj. me arsyetim se i përkasin teorisë së gjymtyrëve homogjene të fjalisë dhe jo togfjalëshit.

Këto janë veçoritë më kryesore të kësaj njësie sintaksore në pika të shkurtra në gjuhësinë tonë.

3 Në gjuhësinë e përgjithshme

Kjo njësi gjuhësore njihet me emra të ndryshëm. Në gjuhësinë frënge përdoren termat *group du mots* dhe *le syntagme* (nga greq. *syntagma*), në gjuhën angleze: *word-combination*, *word-group phrase* dhe, në kohë të fundit, vetëm *phrase*; në gjuhën gjermane *Wortgefüge*, ndërsa në kohë të fundit kryesisht *Worgruppen* dhe *Phrasen*; në gjuhën ruse njihet me emrin *slovoçetanije* etj.

Trajtimi shkencor-teorik i kësaj njësie dallon nga gjuha në gjuhë, nga njëri drejtim gjuhësor në tjetrin etj. Por, me daljen në skenë të drejtimeve gjuhësore të strukturalizmit, të funksionalizmit, të distribucionalizmit, e sidomos të gjuhësisë gjenerative-transformative në krye me studiuesin e njohur **N. Çomski** (Noam Chomsky) jo vetëm çështja e emërimit, por edhe ajo e trajtimit shkencor, si duket, kanë shkuar kah konvergjimi. Të shohim shkurtimisht se si është përkufizuar e klasifikuar etj. , kjo njësi në disa studime, gramatika e fjalorë të gjuhëve të ndryshme:

Sipas **F. dë Sosyr-it** (Ferdinand de Saussure), sintagma përbëhet gjithmonë nga dy ose më shumë njësi konsektive, si në shembujt e dhënë. : *re-lire*; *contre tous*; *la vie humaine*; *dieu est bon*; *s'il fait beau temps nous sortirons* . Kjo do të thotë se nocioni për sintagmë është shumë më i gjerë te ky studiues i njohur i strukturalizmit, ngase mund të nisë me një fjalë të përbërë, me rrjedhojat e saj, me pjesë fjali dhe përfundon me fjali të tëra të përbëra. Për analogji me këtë kemi këta shembuj në gjuhën tonë: përhap(=për+hap), para shtëpisë, fushë e gjerë, qielli është i kaltër;po të kem kohë, do të vij.

Funksionalisti **A. Martine** (A. Martinet) në studimet e tij flet për sintagmën, sintagmën autonome dhe sintagmën e ndërliqshme. Sipas tij, sintagma përbën "çdo lloj kombinimi monemash, raportet reciproke të të cilave janë më të ngushta sesa që janë raportet që kanë ato me ekuivalencat e tjera të thënies, plus eventualisht, monema funksionale që lidh këtë kombinim me pjesën tjetër të thënies". Ndërsa "sintagma autonome është kombinim i dy a më shumë monemave, funksioni i të cilave varet nga vendi i saj në thënie. Mund të jetë i tipit vitin që shkoi, ku tërësia e monemave në fjalë e indikon raportin me kontekstin. Por më shumë mban një monemë funksionale (monemat që shërbejnë për të shënjuar funksionin e një moneme tjetër, . p. sh. pa fjalët për, me etj. , -A. S) që siguron autonominë e grupit. Segmentet me veturë, me valixhet e mia etj. , sipas

këtij studiuesi, janë sintagma autonome. Ndërsa sintagma të ndërliqshme janë ndërtimet: me valixhet e mia, me dëshirën më të madhe.

N. Çomski në shqyrtimet e tij teorike ka përdorur termin *phrase*. Dhe sipas tij, sentenca mund të zërthehet në një frazë nominale (emërore) dhe në një frazë tjetër verbale (foljore). Këto, sipas tij, janë frazat kryesore. Fraza nominale (emërore), më pastaj mund të zërthehet në: një dhe në emër, ndërsa fraza verbale (foljore) në: folje dhe në ndonjë frazë nominale (emërore), e paraqitur me këto simbole të gjuhës angleze:

1. Sentence — NP+VP (The man hit the ball);
2. NP — T+N (The man); dhe
3. VP — Verb + NP (hit + the ball).

D. Kristel-i (Kristal) në **Fjalorin enciklopedik të gjuhësisë moderne** termin sintagmë (Phrase) e ka shpjeguar në këtë mënyrë: "Është term i analizës gramatikore i cili shënon elementet e një strukture që përmban më shumë se një fjalë, por që nuk e ka strukturën SUBJEKT-PREDIKAT, karakteristikë për klauzën (klauza /clause/ në gjuhën angleze mund të konsiderohet një fjali kallëzuesore, që nuk e ka intonacionin e vetë të përmbartimit, por me klauza të tjera mund të sajojë një fjali me të gjitha elementet e domosdoshme; angl. Sentece, frgj. phrase -nënviz. imi, A. S.), kështu që e ka vendin në mes klauzës dhe fjalës.

Ai aty ka përmendur këto lloje sintagmash: sintagmat ndajfoljore (p. sh. herët në mëngjes...), sintagmat mbiemërore (p. sh. shtëpia e vjetër dhe e rrënuar), sintagmat parafjalore (p. sh. në këtë moment...).

Edhe gjuhëtari francez O. Soutet sintagmën e ka përkufizuar si një përbërës të fjalisë kallëzuesore (termi të frëngjishtes la proposition i përgjigjet termi clause të anglishtes, -nënv. imi A. S.), i cili ka ndonjë përbërës të varur, të morfemës. Të gjitha sintagmat, sipas këtij studiuesi, karakterizohen nga morfemat një të tyre. Kurse, sa u përket llojeve, ai ka dalluar: a) Sintagmat emërore (SN, p. sh. : le garçon, le petit garçon, le garçon qui mange), b) sintagmat mbiemërore (SA fier, tres fier, tres fier de sa reussite), c) sintagmat parafjalore (SP, p. sh. malgre cette decision, compte tenu de cette decision) dhe d) sintagmat foljore (SV, p. sh. profite de ses vacances). Edhe ky studiues, sikurse Çomski, fjalët e vetme si p. sh. le garçon, i konsideron sintagmë nominale, ngase ajo përbëhet nga bërthama emërore garçon dhe nyja e përparme le, si përcaktor.

Katër lloje të togfjalëshash i ka vënë në dukje edhe studiuesi gjerman **K. Heinz Ramers** në *Einführung in die Syntax* (botuar në Shtutgard, 2000). Ai ka radhitur aty togfjalëshat emërorë (Nominalphrasen ose Substantivgruppe), foljorë (Verbalphrasen), mbiemërorë (Adjektivphrasen) dhe parafjalorë (Prepositionphrasen). Sa për togfjalëshat ndajfoljorë (Adverbialphrasen), në një shënim në fund të faqes thotë se ky grup në gjuhën gjermane ka mbetur në marginalitet, ndonëse ekzistojnë rastet që e dëshmojnë të kundërtën (p. sh. : heute früh, gestern Morgen, sehr oft).

Edhe te ky studiues, sikurse te A. Martineja, te O. Soutet-i e ndonjë tjetër, është marrë në spikamë rasti kur nga gjymtyra emërore e një fjalie kryesore a drejtuese varet një fjali përcaktore. Dhe këto dy elemente përbëjnë një togfjalësh emëror (p. sh. : Kinder, die

in Stuttgart leben ... /Fëmijët të cilët jetojnë në Shtuttgart, ... nënv. A. S. , po aty f. 27). Ndërsa ajo më e rëndësishmja është kur një trajtë foljore e fjalisë kryesore a drejtuese është gjymtyra kryesore e togfjalëshit foljor, nga e cila trajtë varet një fjali e tërë kallëzuese (p. sh. : Eva **glaubt**, dass Peter ist krank) .

4 Disa krahasime. Përfundime

Edhe nga këto pak të dhëna që i prezantuar këtu, shihet se në trajtimin e togfjalëshit në gjuhën tonë dhe në gjuhë të tjera ka disa pika dallimi, si në çështjen e përkufizimit, po ashtu edhe në atë të klasifikimit e çështje të tjera. Derisa në gjuhësinë tonë merren parasysh vetëm raportet e varësisë së fjalëve në togfjalësha, në studimet e gjuhëve të tjera nuk përjashtohen edhe raportet e bashkërenditjes (shih shembullin te D. Kristel-i: Shtëpia e vjetër dhe e rrënuar,); në teorinë gjuhësore të togfjalëshit në gjuhën tonë nuk janë marrë parasysh rastet kur nga një fjalë kryesore varet një fjali e tërë ftilluese e rrethore. Pastaj, në gjuhësinë e përgjithshme asnjëherë nuk bëhet fjalë për qenësinë e togfjalëshave predikativë, siç është pranuar në gjuhën tonë.

Edhe sa i përket klasifikimit të tyre mund të vihen re disa dallime: Derisa në gjuhësinë tonë pranohen togfjalëshat numërorë e përemërorë, në veprat e cituara të gjuhësisë botërore, askund nuk gjejmë këtë klasifikim. Në gjuhësinë tonë nuk përmenden askund togfjalëshat parafjalorë, ngase këtë gjë nuk e lejon rregulla e përkufizimit (meqë, sipas saj, nuk mund të krijojnë togfjalësha fjalët shërbyese).

Duke i shfletuar disa gramatika të gjuhës ruse, filluar me atë të Akademisë së Shkencave të ish-Bashkimit Sovjetik **Grammatika russkova jazyka**, vëll. II, pj. I (redaktuar nga Vinogradovi dhe botuar në Moskë, më 1954), e deri te ato të viteve '80-ta (shih p. sh. tekstin **Sintaksis savremennova russkova jazyka**, të autorit **N. S. Valgina**, botuar në Moskë, më 1978), mund të vëmë re shumë përngjasime në çështjen e përkufizimit e të klasifikimit të togfjalëshit të gjuhës sonë edhe të **sllovasaçetnije-s** të kësaj gjuhe. Në këto gramatika përgjithësisht pranohet përkufizimi, i cili thotë:

Eta smyslloviye i grammatičeskoje objedimjenje dvuh (ili neskolki) pollnoznačenyh sllov ili form sllov, projavljajushče ih podčiniteljnye svojstva

si dhe 6 grupe togfjalëshash, në mesin e të cilëve edhe ata numërorë dhe përemërorë. Kjo ka qenë gjuha dhe literatura kryesore në të cilën është mbështetur S. Floqi "në krijimin e rregullave teorike" sa i përket trajtimit shkencor të togfjalëshit në gjuhën tonë. Mirëpo, "në të arriturat dhe rezultatet shkencore" të kësaj gjuhe e literature nuk është mbështetur vetëm gjuhëtari a studiuesi shqiptar, por, në përgjithësi, të gjithë studiuesit e shkencave shoqërore, humanitare, natyrore etj. të vendeve të ish-blokut socialist atëbotë. Madje, në të shumtën e rasteve, kjo gjë ishte domosdoshmëri, në kohën e mbizotërimit të sistemit monist.

Në gramatikën "*Sovremennyj russkij literaturnij jazyk*" të një grupi autorësh (redaktuar nga **N. M. Shanskij** dhe botuar në Leningrad më 1988), mund të shihet në këto vite një avansim teorik i kësaj çështjeje. Këtu bëhet një përpjekje e arsyeshme për t'i klasifikuar drejt togfjalëshat e kësaj gjuhe. Në këtë tekst, të gjithë togfjalëshat janë ndarë në 4 grupe e jo 6, siç i kemi pasur deri më tani:

1. Togfjalëshat foljorë (me fjalën kryesore folje);
2. Togfjalëshat substantivë (me fjalën kryesore: një emër, një përemër emëror, një numëror të emëruar etj.);
3. Togfjalëshat mbiemërorë (me fjalën kryesore mbiemër, përemër mbiemëror etj.) dhe
4. Togfjalëshat ndajfoljorë (me fjalën kryesore ndajfolje etj.)¹.

Në grupin e 2-të, siç mund të shihet, janë futur të gjithë togfjalëshat emërorë (substantivë) dhe kjo, sipas mendimit tonë, është dashur të bëhet edhe në gjuhën tonë, (nëse është dashur që të përcillet me çdo kusht literatura gjuhësore shkencore e kësaj gjuhe!!!), ngase togfjalëshat numërorë dhe përemërorë nuk mund të ketë. Nuk mund të ketë, për mendimin tonë, për arsye se të gjithë numërorët themelorë dhe rreshtorë, të shoqëruar me trajta emërore, janë vetëm përcaktorë të këtyre trajtave, p. sh. dy shokë, tre studentë /tri studente; viti i parë etj, d. m. th. janë gjymtyrë të varura. Nëse këta numërorë përdoren si të pavarur, atëherë bartin në vete të gjitha tiparet e frymorëve e të gjësendeve. Prandaj emërzohen. Meqë mund të emërzohen kontekstualisht (p. sh. : dy prej shokëve, i treti me radhë. . .), atëherë gjithsesi i takojnë grupit të togfjalëshave emërorë. E njëjta gjë vlen edhe për përemrat përcaktorë, (p. sh. përemrat dëftorë: ky shok, kjo mikesh etj. , pronorë: shoku im, shoqja ime etj. , pyetës: cili shok, cila shoqe? etj. etj.). Ky është fundifundit kriteri sintaksor që po zbatohet sot, në të shumtën e rasteve, edhe në klasifikimin e pjesëve të ligjëratës në gramatikën e gjuhëve e studimeve më të avansuara botërore.

¹shih tekstin e lartcituar, f. 527.